

KËSHILLI I PAQES KORÇË NGRE SIPARIN E AKTIVITETEVE PËR 100 VJETORIN E PAVARËSISË TË QYTETIT

Korça, një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në shpalljen e pavarësisë së vendit në 28 nëntor 1912 duke dërguar një delegacion të plotë në Kuvendin e Vlorës, duke pasur edhe gjashtë nga 40 nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë, që vinin nga kjo trevë. Këto dhe shumë fakte të tjera u ritheksuan dhe u vlerësuan në konferencën e përbashkët të Këshillit të Paqes Korçë dhe departamentit të Historisë pranë UFSN Korçë.

Siç dihet gjatë gjithë vitit 2012 qeveria qendrore dhe ato vendore kanë organizuar aktivitete në kujtim të 100 vjetorit të shpalljes së pavarësisë anembanë vendit. Pas Konferencës Ndërkombëtare mbi Lidershipin që u mbajt në Tiranë gjatë muajit prill, konferenca e mbajtur të premten në mesditë 23 nëntor në amfiteatrin e universitetit shtetëror të Korçës ishte aktiviteti I dytë që FPU organizon në këtë kuadër. Dhe për këtë duhen përgëzuar si kryetari i KP Korçë z. Niko Faber ashtu edhe anëtarët aktivë të Këshillit si z. Dionis Kotmilo, znj. Elfrida Zefi apo znj. Klara Cela, pa harruar sekretarin e përgjithshëm z. Ermir Hoxha, një student i UFSN.

Që prej disa kohësh KP Korçë ka vendosur një bashkëpunim të mirë me drejtuesit e universitetit Fan Noli të cilët kanë hapur dyert e tij edhe për organizata nga shoqëria civile. Ky ishte në fakt aktiviteti i dytë brenda këtij viti në këtë universitet.



Sipas informacioneve tona, ky ishte aktiviteti i parë gjatë muajit nëntor që zhvillohej në qytet në kuadër të festimeve të 100 vjetorit dhe kjo nuk është pa rëndësi, pasi tërhoqi vëmendjen e mediave lokale si edhe interesin e studentëve, të cilët mbushën 200 vendet e amfiteatrit të këtij universiteti. Megjithëse aktiviteti filloi rreth orës 13:00, kjo nuk u bë pengesë për pjesëmarrësit dhe tetë referuesit e konferencës që të qëndronin dhe ndiqnin me interes deri në fund atë.

Fjalën e hapjes e mbajti sek. përgj. i FPU, z. S. Rexhepi i cili kishte udhëtuar nga Tirana posaçërisht për të marrë pjesë në këtë aktivitet së bashku me z. Gani Rroshi, presidentin e FFPBB.

Gjatë fjalës së tij ai iu referua figurës së ndritur e fisnike të Ismail Qemalit, një figure kryesore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e cila kulmoi me shpalljen e pavarësisë në Vlorë më 28 nëntor 1912. Ismail Qemali ishte një politikan e diplomat mjaft i dëgjuar gjatë sundimit Otoman në Shqipëri, i cili kur kuptoi se Perandorisë Osmane po i vinte fundi vendosi të braktiste postet qeveritare që i patën ofruar osmanët dhe të punonte për pavarësinë e Shqipërisë. “Ai refuzoi postin e ministrit të jashtëm dhe atij të brendshëm njëkohësisht pa përpara se të fillonte udhëtimin nëer kancelaritë kryesore Evropiane. Ai gjithashtu shkriu gjithë pasurinë dhe influencën e tij për hir të kombit duke vendosur kështu modelin fisnik që një patriot duhet të ndjekë” tha z. Rexhepi gjatë fjalës së tij.



“A kemi ne liderë të tillë sot? Fatkeqësisht jo... Nëse nuk do të kemi të tillë liderësh altruistë që japin gjithçka për hir të kombit ne nuk do të jemi në gjendje kurrë të përmbushim ëndrrën e etërve themelues të kombit tonë”, përfundoi ai.

Folësja tjetër ishte znj. Elfrida Zefi, nënkryetare e KP Korçë dhe njëkohësisht pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë e cila u pasua nga shefi i departamentit të historisë i cili trajtoi temën “Shpallja e pavarësisë kombëtare - tipar i patriotëve shqiptarë”. Pas tij ishte znj. Klara Çela e cila duke qenë një aktiviste e çështjeve gjinore trajtoi temën interesante “Kontributi i grave në fitoren e pavarësisë”. Zonja Nada Bandilli vuri në dukje kontributin e patriotëve korçarë në shpalljen e pavarësisë ndërsa doc. Donika Dardha hodhi dritë mbi peripecitë që iu desh të kalonin motrave Qiriazi dhe patriotëve të tjerë korçarë për hapjen e shkollës së parë shqipe si pioniere e arsimit tonë kombëtar. Dy pedagogë të rinj, por mjaft të pasionuar, hodhën dritë mbi dy patriotë të shquar të rilindjes si Asdreni (Alba Kreka) dhe Mihal Grameno (Metin Venxha) duke mbajtur deri në fund të ndezur interesin për këtë konferencë. Në fund një nga studentët e UFSN emocionoi gjithë të pranishmit duke recituar poemën e Ndre Mjedës “O Mojt Shqypni”.





Mund të themi pa ndrojtje se ky aktivitet ishte nga më të suksesshmit të organizuara nga KP Korçë duke marrë parasysh numrin e pjesëmarrësve, cilësinë e fjalimeve dhe nivelin e pjesëmarrësve. Gjithashtu aktiviteti në fjalë u pasqyrua në edicionet e lajmeve të të tria televizioneve lokale.

Raportoi
Sokol Rexhepi

